



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfer -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT - CENTRALNA AGENCIA NABAVKE - CENTRAL PROCUREMENT

MARRËVESHJA PUBLIKE KORNIZË

1. Agjencia Qendrore e Prokurimit (më tej i quajtur "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë; dhe
2. Operatorë Ekonomik apo Grup i Operatorëve Ekonomik të paraqitur në tabelën në Nenin 6.1 të marrëveshjes (më tej i quajtur "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar si në vijim

Për të përmbyllur një kontratë publike kornizë: Marrëveshje kornizë për Furnizim me Pemë dhe Perime me numër të prokurimi: UA/2016-23-4807-1-1-1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kësaj marrëveshje publike kornizë është për tu pajtuar mbi rregullat për krijimin e kontratave ndihmese të cilat do të kryhen përmes procesit të mini-konkurrencës vetëm në mes të operatorëve ekonomik që janë palë të kontratës publike kornizë.
- 1.2 Kjo kontratë publike kornizë në vetvete nuk është një kontratë, por përcakton termat dhe kushtet për kontrata ndihmese. Specifikat teknike në aneksin 1 që janë pjese e kësaj kontrate janë vetëm specifika minimale ndërsa gjatë implementimit të kontratës gjatë përdorimit të mini tenderëve AK-së do të përdorin specifikat teknike të Aneksit 1 ose do të hartojnë specifikat teknike më të avancuara sipas nevojave dhe kërkesave
- 1.3 Furnizuesi është vetëm njëra nga palët e kontratës publike kornizë.
- 1.4 Palët tjera të Marrëveshjes publike kornizë janë të përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate.

Neni 2 Obligimet

2.1 Autoriteti kontraktues, me këtë rast, konfirmon se do t'i lëshojnë Furnizuesit "Ftesë për Kuotim" (FPK) sa herë që të shfaqet nevoja për furnizim.

2.2 Furnizuesi, nga ana tjetër, pajtohet që të bëhet njëra nga palët e Marrëveshjes publike kornizë dhe të paraqesë një ofertë sa herë që kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese që përdorin këtë marrëveshje .

Neni 3 Kontratat Ndhmëse

3.1 Kontratat ndihmëse do të jepen vetëm nëpërmjet një procesi të mini-konkurrencës.

Neni 4 Procesi i Mini-konkurrencës

4.1 Procesi i mini-konkurrencës do të kryhet në mes të të gjitha palëve të marrëveshje publike kornizë sa herë që të shfaqet nevoja për furnizim për Autoritetet Kontraktuese që përdorin këtë marrëveshje .

4.2 Autoritetet Kontraktuese të identifikuar do të ri-hapin konkurrencën në bazë të kushteve të njëjta ose të formuluar më saktësisht, nëse është e nevojshme, të definuar në Pjesën A të Dosjes së Tenderit.

4.3 Sa herë që të shfaqet nevoja për furnizim , Autoritetet kontraktuese do të përgatisin Ftesën për Kuotim (FPK) dhe do të lëshojnë FPK për të gjitha palët e kontratës publike kornizë. Vlerësimi i kontratës ndihmëse do të bazohet në kriteret e theksuara në FPK.

4.2 Çdo kontratë ndihmëse do të jete subjekt i publikimit të Njoftim për Dhënie e Kontratës, ti nënshtrohet kërkesave për nënshkrimin e kontratës dhe rregullave të paraqitjes së ankesave në përputhje me LPP.

Neni 5 Termet dhe Kushtet

5.1 Termet dhe kushtet për kontratat ndihmëse përcaktohen në Pjesën B të Dosjes së tenderit, Seksioni I, II, III.

Neni 6 Palët e Kontratës Publike Kornizë

6.1 Palët e kontratës publike kornizë janë si më poshtë:

Nr.	Emri dhe adresa e palëve
1.	Burimi Corporation SH.P.K. rruga Hajdar Dushi , Prishtinë
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik Fisnik.S. Neziri B.I.Doni Fruitts. Sh.p.k
3.	Beni Dona Plast SH.P.K. Ulpiana Tregu i Gjelbërt, PRISHTINË
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik ENZO SH.P.K.; N.T.P HAJDINI COMERC Rr. Ilaz Kodra - Drenas, DRENAS
5.	Dauti Komerc Sh.P.K Gërllicë, Ferizaj

Neni 7 Kohëzgjatja e Marrëveshjes Publike Kornizë

7.1 Zbatimi i kësaj Marrëveshje Publike Kornizë do të fillojë me datë 01 shtator 2023 dhe do të përfundoj me datën 31 gusht 2024.

7.2 Agjencia Qendrore e Prokurimit ka nënshkruar marrëveshjet publike kornizë me 5 (Pesë) operatorë apo Grupe operatorësh ekonomik të lartpërmendur në Nenin 6.1.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit: MEHMET RAMA

Nënshkrimi

Datë: 07 gusht 2023



PARATHENIE

Sipas nenit 94 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- ✓ Zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Autoritete Kontraktuese;
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, kryen aktivitetet e prokurimit në emër të tyre; dhe
- ✓ Me kërkesën e Autoriteteve Kontraktuese, ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Ne bazë të Udhëzimit Administrativ- Nr. 07/140 datë 26 prill 2023 për implementimin e procedurave qendrore të prokurimit publik, AQP është autorizuar që të fillojë me procedurat qendrore për Furnizim me Pemë dhe Perime në emër të Autoriteteve kontraktuese (shih listën e autoriteteve kontraktuese në Aneksin 7)

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me Pemë dhe perime Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7. Furnizuesit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7.

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) ka për qëllim të lidhë marrëveshje kornizë me disa operatorë ekonomik të cilët do të kenë kapacitet për të Furnizuar me pemë dhe perime Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7.

AQP do të kolojdojë kontratën publike - Marrëveshjen kornizë kurse Ri-hapja e konkurrencës (mini-konkurrenca) do të kryhen nga Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7 sa herë që kanë nevojë.

Të gjithë Operatorët Ekonomikë të cilët bëhen palë të **Marrëveshjes Publike Kornizë** fillimisht do të nënshkruajnë **Draft Marrëveshjen Publike Kornizë, shih Seksionin VI të pjesës B të kësaj Dosjeje të Tenderit**, dhe pas mini-konkurrencës i cili do të mbahet në mes të palëve të Marrëveshjes Publike Kornizë, kushtet e kontratës të cilat do të mbizotërojnë janë, referojuni seksionit I-V të Pjesës B.

Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të pemëve dhe perimeve nga cilido shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur malli të dorëzohet në pronësi të AK.

AK të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë të drejtë të refuzojnë çdo dërgesë e cila dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në këtë specifikim teknik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit të kontratës (Marrëveshjeve kornizë) do të shpërndaje nga një kopje të nënshkruar të kontratës tek secili Autoritet Kontraktues i identifikuar në Aneksin 7. Një kopje e kontratës së nënshkruar do të publikohet në webfaqen e AQP-se.

Disa Autoritete Kontraktuese të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë kontratat e tyre ekzistuese të cilat janë si rezultat i Mini konkurrencës të zhvilluar me Marrëveshjen kornizë në fuqi, nuk do të ndërpriten, por do të vazhdojnë deri në datën e skadimit. Dy javë para skadimit të kontratës autoriteti përkatës kontraktues do të njoftoj me shkrim Agjencionin Qendror të Prokurimit dhe Operatorin ekonomik lidhur me datën e skadimit e të kontratës dhe datën e fillimit të shfrytëzimit të kontratës kornizë.

Furnizuesi do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Çdo AK i specifikuar në Aneksin 7 (Komfor Udhëzimit Administrativ- Nr. 07/140 datë 26 prill 2023) do të emërojë një përfaqësues si pikë kontaktuese ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe OE i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Përshkrimi i detajuar për artikujt sipas Aneksit 1 duhet të bëhet nga AK-se në fazën Mini -konkurrencës

Nr. rendor	Përshkrimi	Njësia
1.	Domate te freskta	kg
2.	Groshë e bardhë e klasit te pare	kg
3.	Brokoli	kg
4.	Domate te zeza te fresketa	kg
5.	Karrotë e freskët	kg
6.	Lakër e freskët	kg
7.	Lakër e kuqe (per sallat)	kg
8.	Lule lakër e freskët	kg
9.	Magdonoz	50 g
10.	Spinaq	kg
11.	Bishtaja te freskta	kg

12.	Bizele (grashak) te freskta	kg
13.	Patate	kg
14.	Qepë	kg
15.	Qepe te gjelberta	tube
16.	Qepe te kuqe	kg
17.	Hudhra	kg
18.	Specë te pa djeges	kg
19.	Speca per mbushje	kg
20.	Trangull	kg
21.	Kungulleshka	kg
22.	Presh (purri)	kg
23.	Sallate e gjelbert	copë
24.	Banane	kg
25.	Limon	kg
26.	Mollë e embel	kg
27.	Molle majoshe	kg
28.	Molle te fresketa	kg
29.	Portokall	kg
30.	Dardhe	kg
31.	Dredheza	kg
32.	Mandarina	kg
33.	Kumbulla te fresketa	kg
34.	Pjeshka	kg
35.	Pjepen	kg
36.	Shalqin (boston)	kg
37.	Kivi	kg
38.	Rrush	kg
39.	Qershija	kg
40.	Selino (celer)	kg
41.	Molle e gjelbert	kg
42.	Speca te kuqe	kg
43.	Nektarine	kg
44.	Shege	kg
45.	Xhenxhifil	kg
46.	Fasule	kg
47.	Kungull	kg
48.	Bamje	Kg
49.	Greipfrut 150-200 gr	kg

Pemët dhe perimet duhet të jenë të freskëta, të klasit të parë (jo të dëmtuara).

Marrëveshja kornizë për pemë dhe perime zhvillohet komfor Nenit 38 paragrafi 4 dhe Nenit 38 paragrafi 5 nënparagrafi 2.